VENDIM
Nr. 1080, datë 23.12.2015

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.11.2015, PËR ÇËSHTJEN "SHARRA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMET NR. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 DHE 2032/12)

(Ndryshuar me VKM nr. 616, datë 31.8.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.11.2015, për çështjen "Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimet nr. 25038/08 (Sharra), nr. 64376/09 (Xibinaku dhe të tjerë), nr. 64399/09 (Frashëri), nr. 347/10 (Maçi), nr. 1376/10 (Çoka), nr. 4036/10 (Dvorani dhe Dume), nr. 12889/10 (Asllani), nr. 20240/10 (Agolli), nr. 29442/10 (Talipi/Peshkëpia), nr. 29617/10 (Kati), nr. 33154/11 (Vrioni) dhe nr. 2032/12 (Lelo), sipas listës së ankuesve, në shtojcën 1, dhe shumat e përcaktuara në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Ekzekutimin, në zbatim të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të vendimeve të komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, për aplikimet nr. 33154/11 (Vrioni) dhe nr. 347/10 (Maçi).

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, gjatë ekzekutimit të këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.11.2015, për secilën çështje.

5. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve të çështjes "Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për ankimet nr. 25038/08 (Sharra), nr. 64376/09 (Xibinaku dhe të tjerë), nr. 64399/09 (Frashëri), nr. 1376/10 (Çoka), nr. 4036/10 (Dvorani dhe Dume), nr. 12889/10 (Asllani), nr. 20240/10 (Agolli), nr. 29442/10 (Talipi/ Peshkëpia), nr. 29617/10 (Kati), dhe nr. 2032/12 (Lelo), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga fondi i kontingjencës, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

6. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 5, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme të paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

7. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKANTËVE

Nr.	Çështja dhe numri	Emri i aplikuesve (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga:	Data e prezantimit
1.	Sharra, nr. 25038/08	Zamira Sharra (1956)	Shqipëri	A. Brovina, avokat	15 maj 2008
2.	Xibinaku dhe të tjerë nr. 64376/09	Miriam Xibinaku (1948) Sanie Kaceli (1948) Miron Nuri (1952) Qeriman Nuri (1935) Malfor Nuri (1964) Erina Llapaj (1952) Liliana Llapaj (1956) Nermin Harxhi (1957) Edmond Harxhi (1959) Shpresa Tartari (1940) Mirgjin Tartari (1941) Behare Tartari (1953) Enjana Tartari (1980) Stela Tartari (1983) Ledi Tartari (1991) Mirjane Tartari (1955) Arlind Tartari (1982) Ariona Tartari (1986)	Shqipëri Kanada Shqipëri Itali SHBA Shqipëri Itali Shqipëri	S. Puto,avokat	4 dhjetor 2009
3.	Frashëri, nr. 64399/09	Tarik Shkreli (1950) Fiqirete Frashëri (1930) Hajri Frashëri (1951) Hysref Frashëri (1956) Ilona Ziso (1962) Naide (Nahide) Shkodra (1929) zëvendësohet nga trashëgimtarët e saj Rozafa Çabej Shkodra dhe Valbona Mardodaj Çabej Shkodra dhe Valbona Mardodaj Shkodra	Shqipëri	S. Puto, avokat	4 dhjetor 2009
4.	Maçi, nr. 347/10	Musa Maçi (1934) Kujtim Maçi (1943) gjithashtu përfaqëson Giorgia dall'Olmo (Maçi) (1925), Roberto Maçi (1948), Alessandro Maçi (1955) dhe Tomor Maçi (1937))	Shqipëri Shqipëri Itali	A. Tartari,avokat	13 dhjetor 2009
5.	Çoka, nr. 1376/10	Sotir Çoka (1932) Tefta Çoka (1938) Teodor Çoka (1964) Arben Çoka (1960)	Shqipëri	S. Puto and A. Memi Prifti, avokatë	22 dhjetor 2009
6.	Dvorani dhe Dume, nr. 4036/10	Shpëtim Dvorani (1938) Valter Dvorani (1952) Pranvera Dvorani Bejleri (1954) Diana Dvorani Qyteti (1958) Gurie Dvorani Starova (1925) zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj Lejla Ago Belli (1944) Svjetllana Dume (1949) Besa Dume (1952) Fatbardha Dume (1954)	Shqipëri	S. Puto, avokat	23 dhjetor 2009
7.	Asllani, nr. 12889/10	Albert Asllani (1939)	Shqipëri	S. Dodbiba, avokat	5 shkurt 2010
8.	Agolli, nr. 20240/10	Tefta Agolli (1931) zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj Ilir Shijaku (1950) dhe Deshira Keta Shijaku (1954) Arben Agolli (1957) Sokol Agolli (1951) Kreshnik Agolli (1956) Ganimet Agolli (1931) Afërdita Agolli (1954) Elira Agolli (1963) Semiha Agolli (1935) Artur Agolli (1958) Valbona Permeti Agolli (1963) Flutura Agolli (1946) Parid Agolli (1979)	Shqipëri	A. Hajdari and A. Brovina, avokat	6 pPrill 2010

9.	Talipi (Peshkëpiia), nr. 29442/10	Bardhyl Talipi (Peshkëpia) (1946)	SHBA	S. Dodbiba,avokat	10 prill 2010
10.	Kati, nr. 29617/10	Fabian Kati (1963) Anila Kati (1956)	Shqipëria	A. Hajdari dhe A. Brovina, avokat	20 maj 2010
11.	Vrioni, nr. 33154/11	Turhan Vrioni (1944)	Shqipëria	A. Tartari, avokat	11maj 2011
12.	Lelo, nr. 2032/12	Ervin Lelo (1974)	Shqipëria	S. Puto, avokat	19 dhjetor 2011

SHTOJCA 2
SHPËRBLIMI
(Ndryshuar nr. rendor 10 me VKM nr. 616, datë 31.8.2016)

Nr.	**Aplikimi dhe numri**	**Dëmi pasuror dhe dëmi jopasuror**	**Kostot dhe shpenzimet**
1.	Sharra, nr. 25038/08	191,400 euro (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
2.	Xibinaku dhe të tjerë, nr. 64376/09	87,000 euro (tetëdhjetë e shtatë mijë).	
3.	Frashëri, nr. 64399/09	670,000 euro (gjashtë qind e shtatëdhjetë mijë)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
4.	Maçi, nr. 347/10	Nuk ka ankesa (ankesat jashtë afatit)	Asnjë (nuk ka pretendime)
5.	Çoka, nr. 1376/10	2,331,400 euro (dy milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e katërqind)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
6.	Dvorani dhe Dume, nr. 4036/10	748,900 euro (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
7.	Asllani, nr. 12889/10	106,300 euro (njëqind e gjashtë mijë e treqind)	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
8.	Agolli, nr. 20240/10	732,450 euro (shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë).
9.	Talipi (Peshkëpia), nr. 29442/10	19,300 euro (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind)	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
10.	*Kati, nr. 29617/10*	*117 600 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind)*	*850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro*
11.	Vrioni, nr. 33154/11	Asnjë (pretendimet jashtë afatit)	Asnjë (nuk ka pretendime)
12.	Lelo, nr. 2032/12	258,200 euro (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind)	550 euro (pesëqind e pesëdhjetë)